



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.12.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 13, 14 dhe 21 nëntor 2018.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”.
3. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ervin Bushati, Adnor Shameti, Xhemal Qefalia, Klotilda Bushka, Evis Kushi, Elona Hoxha, Ilir Xhakolli, Vasilika Hysi dhe Eglantina Gjermani.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjasha, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari, Edmond Panariti dhe Andrea Marto.

Të ftuar:

Odeta Fëngjilli – Drejtoreshë e Marrëdhënieve Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë

Arqile Koca – Prokuror/Drejtor i Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme

Manuela Imeraj – Oficere e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme

Jonad Bare – Oficer i Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Fillojmë mbledhjen e komisionit, datë 17.12.2018, me këtë rend dite: miratimin e procesverbaleve të datave 13, 14 dhe 21 nëntor, si dhe shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”.

Fillojmë me miratimin e procesverbaleve të datave 13, 14 dhe 21 nëntor 2018. Ka vërejtje? Biem dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Faleminderit!

Miratohen të tria procesverbalet.

Vazhdojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”.

Të ftuar për të raportuar në komision kemi zonjën Odeta Fëngjilli, drejtoreshë e Marrëdhënieve Juridiksionale..., apo nuk jeni drejtoreshë dhe vini në emër të kësaj drejtorie?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni drejtoreshë? Pra, jeni drejtoreshë për Marrëdhëniet Juridiksionale. A ka fjalë “juridiksionale” në shqip?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jurisdictional. Nuk ka fjalë “juridiksionale”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në shqipen që di unë, jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në shqipen që mëson brezi i ri, ndoshta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adnor Shameti – Ajo është shqipja e duhur, zonja kryetare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – E di, zemër, e di!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhe unë shqipen e di mirë, zoti Adnor, e kam mësuar prej vërteti!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam mësuar në kohën kur mësohej shqip.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Adnor Shameti – Të jemi korrektë...

Mimi Kodheli – Është shprehja “Marrëdhënie Juridike”, ndaj pyes: pse duhet të jetë “juridiksionale”? Cili është dallimi ndërmjet shprehjeve “marrëdhënie juridike” dhe “marrëdhënie juridiksionale”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Marrëdhëniet juridike kanë të bëjnë me çështjet që rregullon ligji, ndërkohë që marrëdhëniet juridiksionale kanë të bëjnë me pushtetin që ka një organ i caktuar...

Adnor Shameti – Marrëdhëniet juridiksionale kanë të bëjnë me territorin e huaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Uau! Çfarë thua?! Qenka nivel shumë i lartë drejtoria në fjalë?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di.

Edhe një herë, të ftuar për të raportuar në komision kemi: zonjën Fëngjilli, drejtoreshë e Marrëdhënieve Juridiksionale dhe Bashkëpunimit Ndërgjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë; zonjën Vajushi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Odetta Fëngjilli – Në fakt, është bërë një gabim, zonja Vajushi nuk është prezente.

Mimi Kodheli – Në fakt, që të jemi në rregull me Rregulloren, prezente duhet të ishte ministrja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se ju i keni edhe shefat e sektorëve të zënë me punë!

Gjithashtu, prezent kemi zotin Arqile Koca, prokuror...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Respekte!

Zoti Koca, mos gabo, jeni edhe drejtor i Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pastaj kemi zotin Jonad Bare dhe zonjën Manuela Imeraj, oficerë të Policisë Gjyqësore nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë se keni ardhur!

Ju lutem, zonja Fëngjilli, shumë shkurt, pa qenë nevoja të lexoni relacionin që ne e kemi përpara, na thoni se për çfarë bëhet fjalë në këtë projektligj.

Faleminderit!

Odeta Fëngjilli – Faleminderit!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Projektligji që keni sot për shqyrtim është marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it, e cila është nënshkruar nga ministrja e Drejtësisë në datën 5 tetor të këtij viti dhe është krijuar në bazë të vendimit të Këshillit Europian, duke marrë në konsideratë që Eurojust-i është një organizëm i Bashkimit Europian, që synon nxitjen e luftës kundër krimit të organizuar dhe, çka është më e rëndësishme, ofron mundësinë e financimit të krijimit të ekipeve të përbashkëta hetimore kur hetimi shtrihet në më tepër se dy shtete.

Pjesa më e rëndësishme jona është se kjo marrëveshje do të krijojë mundësi më të mëdha për prokurorinë për të zgjeruar bashkëpunimin e saj në kuadrin e luftës kundër krimit të organizuar.

Mimi Kodheli – Ju falënderoj, zonja drejtoreshë!

Ishit realisht shumë shteruese, madje e kam seriozisht këtë gjë, në ndryshim nga shumë të tjerë, që vijnë këtu dhe i bien nga Kina për të thënë dy fjalë, pra sensin e projektligjit.

Meqenëse jemi te pyetjet, kam një pyetje shumë shkurt: në dijeninë tuaj kur është krijuar Eurojust-i, si institucion?

Odeta Fëngjilli – Eurojust-i është krijuar në datën 28.02.2002.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Madje, deri në hapjen e bisedimeve në vitin 2014, janë dashur shumë vite dhe krijimi i të gjitha kushteve të nevojshme lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale...

Mimi Kodheli – Doja thjesht të krijoja një ide.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kërkoj llogari të tilla, se nuk është në kompetencat e mia, as në juridiksionin tim.

Ka pyetje ose diskutime nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Shameti, keni pyetje? Është në juridiksionin tuaj kjo fushë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, unë ju falënderoj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, ju e dini se të gjitha projektligjet që lidhen me ratifikimin e marrëveshjeve ndërmjet një përfaqësuesi të qeverisë së shtetit shqiptar dhe cilëndo strukturë, organizmi apo

institucioni ndërkombëtar duhet të kalojë në Komisionin Parlamentar për Politikën e Jashtme, për të kuptuar edhe respektimin e të gjithë legjislacionit ndërkombëtar që rregullon këto marrëdhënie.

Ju uroj suksese në punën tuaj të vështirë!

Kështu, nuk më mbetet gjë tjetër, të nderuar kolegë, vetëm ta hedh në votim.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin. Kush është dakord?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Duke ju falënderuar të gjithëve për pjesëmarrjen, e konsideroj të mbyllur këtu mbledhjen e sotme të komisionit!

Punë të mbarë! Suksese!

MBYLLET MBLEDHJA